



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E ISTOGUT

## KONTRATË PËR PUNË

*KOMUNA E ISTOGUT në vazhdim "Njësia e Prokurimit", të cilën e përfaqëson znj, Zizë Bujupaj, menaxhere e Prokurimit, Rruga "Fadil Ferati" Nr. 121 në njërën anë;*

*Dhe*

*KONTRAKTORI "SIB" Shpk, Komuna e Istogut, të cilën e përfaqëson z. Sabit Mslija, me Nr. Rexh. Unik i Biznesit, 811223669 (ne vazhdim Kontraktuesi), ne anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:*

### TITULLI I KONTRATËS:

#### NDËRTIMI I DEPONISË NË TUQEP

<i>Nr. I prokurimit</i>	<i>633-19-1996-5-2-1/ C 328</i>
<i>Nr. I brendshëm</i>	<i>633 / 019/ 003RR / 521</i>

### Neni 1 Lënda:

*1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i furnizimeve dhe punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:*

### NDËRTIMI I DEPONISË NE TUQEP

### Neni 2 Çmimi

**Çmimi 2.1** Çmimi total i punëve per aktivitetin e prokurimit **NDËRTIMI I DEPONISË NË TUQEP** është: **14.875,00 €** dhe me fjalë: **/Katërmëdhjetë mijë tetëdhjetë e katër indeshatë dhjetë e pesë / zero zero €**

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve përgjatë ekzekutimit të kontratës.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

### **Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës**

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;  
Kushtet e Veçanta të Kontratës;  
Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;  
Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet  
Teknike;  
Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);  
Plani për menaxhimin e kontratës  
Proçesverbalet e Vizitës në teren e mbikqyresi

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

### **Neni 4 Komunikimet**

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për





pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

**Për Autoritetin Kontraktues:**  
Komuna e Istogut

**Për: Kontraktuesin:**  
"SIB" Shpk

<b>Emri:</b>	<i>Zizë Bujupaj</i>	<b>Emri:</b>	<i>Sabit Muslija</i>
<b>Pozita:</b>	<i>Zyrtar Përgjrgjës i Prokurimit</i>	<b>Pozita:</b>	<i>D r e j t o r</i>
<b>Nënshkrimi:</b>		<b>Nënshkrimi:</b>	
<b>Data:</b>	<i>22.06.2020</i>	<b>Data:</b>	<i>22.06.2020</i>
<b>Vu la</b>		<b>Vu la</b>	

### PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë GJUHA SHQIPE
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është: Shume e sigurisë së ekzekutimit është;10% E VLERES SE KONTRATES ME VLEFSHMERI 60 DITË ME GJATE SE PERFUNDIMI I KONTRATES.
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 5 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periodha për Programin e azhurnuar është:5 ditë
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë 5 DITE PAS NENSHKRIMIT TE KONTRATES
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 10 dite pas nënshkrimit te kontratës.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë <b>0.25%</b> e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë.  Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	<b>Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishite nga ana e Kontraktuesit,</b>
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit –DREJTORATI I SHERBIMEVE PUBLIKE
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është:s\ka
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: <u>s/ka</u>
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë: 5 ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës		Përqindja që do të zbatohet përvlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është <b>përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve te likuiduara.</b>
Zgjidhja miqësore e	42.2	<b>Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik –</b>

mosmarrëveshjeve		<b>Divizioni i rregullave</b>
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <b>Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë</b>

KOMUNA E ISTOGUT					
TITULLI I AKTIVITETIT					
PARAMASA DHE PARALLOGARIA-Ndertimi deponisë në Tyqep					
	Specifikimi i punëve	Njësia	Sasia	Cmimi/ Njesi	Gjithsejt
<b>Aktivitetet</b>					
1	Largimi i shkurreve dhe materialit te paperdorshem për gjatë tërë trases(siperfaqes) ku do te hapet deponia e re	m <sup>2</sup>	500	1.00	500.00
2	Grumbullimi dhe bartja mbeturinave te shperndara ne siperfaqen afer deponisë dhe hudhja ne deponinë e re	m <sup>3</sup>	100	2.00	200.00
3	Blerja,transporti dhe mbulimi me dhe natyral i tërë siperfaqes së deponisë ekzistuese	m <sup>2</sup>	1000	0.85	850.00
4	Eliminimi i shkurreve,shkulja e drunjeve me rrenjë afer hapsires ku do te hapet deponia,largimi i materialit te deponuar dhe pastrimi i terenti	m <sup>2</sup>	200	1.00	200.00
5	Germimi dhe hapja me bager per deponinë e re afer asaj ekzistuese.Germimi te behet ne thellësi t=6m dhe siperfaqe rreth S=1000m <sup>2</sup> .Ne llogari te futen edhe aktivitetet tjera per nivelizim dhe ngritja e mureve anesore rreth perimetrit te deponisë duke borë cilindrimin(ngjeshjen) ne cdo 50cm dhe trashesi te murit rreth d=2m	m <sup>3</sup>	6,000	0.81	4,860.00
6	Hapja dhe germimi ne deponinë ekzistuese dhe vendosja e gypave te betonit Ø1000 dhe atë ne 4 vende me nga 4 gypa	cope	10	70.00	700.00
7	Pas hapjes së deponisë parashihet rehabilitimi i kohë pas kohshem i mbeturinave dhe hudhjes se tyre qe janë afer deponisë dhe atë 30 herë mbrenda vitit-365 ditë në deponinë e ndertuar	aprox		6,365.00	6,365.00
8	Rehabilitimi i rruges ekzistuese e kat IV-të e cila na shpie deri te deponia.Ne llogari te parashihet planifikimi,transporti dhe mbushja me zhavor natyral dhe zhavor 0-31.5mm dhe atë me nje trashesi d=20cm	m <sup>3</sup>	200	6.00	1,200.00
<b>TOTALI ME TE GJITHA NGARKESAT</b>					<b>14,875.0 €</b>

